

ZHVILLIMET POLITIKE DHE KUSHTETUESE NË KOSOVË NË VITIN 1963-  
1981

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA

ERZA KRASNIQI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

STUDIME PASUNIVERSITARE – MASTER

*Prishtinë, 2023*

# ZHVILLIMET POLITIKE DHE KUSHTETUESE NË KOSOVË NË VITIN 1963-1981

**Mentori: Prof. Asoc.Dr. Selim Bezeraj**

Studimi: *''Zhvillimet politike dhe kushtetuese në Kosovë në vitin 1963-1981''* në thelb pasqyron segmentet nga historia politike, dhe kushtetuese në Kosovë gjatë periudhës 1963, me miratimin e kushtetutës në Republikën Federative Jugosllave, dhe në Republikën Socialiste të Serbisë, dhe minimizimin e statutit që kjo Kushtetutë i solli Rajonit Autonom të Kosovë-Metohisë. Pastaj në vitin 1968, kur në Kosovë shpërthejnë demonstratat e para pas Luftës së Dytë Botërore, e deri në vitin 1981, kur në Kosovë për shkak të pakënaqësive që kishte ngjallur kushtetuta e vitit 1974, e cila në dukje të parë i kishte siguruar Kosovës një varg të drejtash, të cilat më parë Krahina Autonome e Kosovës nuk i kishte pasur, duke e bërë Kosovën pjesë konstitutive të Republikës Federative. Ajo me të cilën shqiptarët e Kosovës po përballëshin çdo ditë ishte së Kosova pavarësisht këtyre ndryshimeve nuk ishte Republikë. Pastaj edhe nga ana serbe, të cilëve nuk i'u kishte zbehur dëshira për një Serbi të Madhe. Këto ishin një ndër arsyet që në Kosovë në vitin 1981 shpërthyen demonstrata masive.

Punimi është i ndarë në tre kapituj. Secili prej këtyre kapitujve do të trajtojë në mënyrë të veçantë specifikat të cilat i përmban.

Kapitulli I : '' Në kapitullin e parë do të flitet për '*Zhvillimet politike dhe ndryshimet kushtetuese të viteve 1963-1968*'', për shqiptarët e Kosovës, Federata Jugosllave ka qenë gjithmonë një shtet totalitar ku vetadministrimi dhe vetëqeverisja asnjëherë nuk u zbatuan plotësisht. Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e vitit 1963, e forcoi më tej tendencën e shndërrimit të RAKM në subjekt ekskluziv të Republikës së Serbisë. Ky kapitull analizon në detaje politikën shkombëtarizuese të pushtetit serb, dhe atij federativ karshi Rajonit Autonom të Kosovës. Pas rënies së Rankoviqit 1966 ndryshimet që u bënë në jetën politike e juridike në federatën jugosllave, ato përsëri nuk e prekën thelbin e sistemit. Në një situatë në të cilën ndodhej Jugosllavia, kjo rënie e tij vetëm i'a zgjati jetën shtetit jugosllav.

Në kapitullin e dytë me titull: '' *Rrethanat politike dhe iniciativat konstitucionale gjatë viteve 1968-1974*'', ky kapitull fillon më demonstratat e vitit 1968, ku shqiptarët e Kosovës i shfrytëzuan situatat që u krijuan, dhe në rrugë legale kërkuan të ndryshonin statusin e tyre

kushtetues. Gjatë kësaj kohe në Kosovë pati tendenca dhe kërkesa për evoluim në statusin kushtetues të Kosovës, ky kapitull ekskluzivisht i'u kushtohet lëvizjeve dhe debateve të të gjitha shtresave të popullësisë së Kosovës, në të gjitha forumet politike e shoqërore, mbi të gjitha, ky kapitull synon të nxjerrë në pah problemet që u shtruan, rrugët dhe metodat që u përdorën për zgjidhjen e këtyre problemeve, dhe rezultatet që u arritën.

Në kapitullin e tretë trajtohen ngjarjet, *'Kushtetuta e KSA e Kosovës e vitit 1974 dhe ngjarjet politike deri në vitin 1981'*, padyshim që Kushtetuta e vitit 1974 shënon evoluimin kryesor kushtetues të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore. Ndërsa demonstratat e vitit 1981 apo ndryshe *rruga e vështirë e Kosovës për Republikë*, tërheqë shumë mendime për zhvillimet pozitive e negative të situatave në Kosovë deri në vitin 1981, shqiptarët mbetën të pabarabartë në federatën jugosllave. Ata nuk zotëronin as statusin e kombit e as atë të republikës. Kërkesa për Republikë të Kosovës, që në mars-prill 1981 mori përmasa gjithëpopullore, në thelb të saj ishte përpjekje për të vendosur një tjetër raport midis politikës shtetërore federative dhe shqiptarëve të Kosovës, ishte kërkesë për barazi në RSF të Jugosllavisë. Më anën e këtyre demonstratave shqiptarët kërkonin të bënin të njohur e të ligjshëm atë realitet të ri që kishte përfshirë rininë e popullsinë shqiptare.

Në këtë studim për të arritur në një konkludim janë përdorur metoda të ndryshme shkencore të studimit, siç është metoda e analizës, duke përdorur këtë metodë është pasqyruar në mënyrë të përgjithshme gjendja në atë kontekst kohorë, dhe pastaj në mënyrë të veçantë është ndarë mendimi im dhe i autorëve lidhur me një çështje të caktuar. Metodë tjetër e cila është përdorur gjatë punimit të këtij studimi është edhe ajo e heuristikës, ku do të ngrisë pyetje të caktuara, dhe të cilave gjatë studimit dhe shtjellimit të çështjes në fjalë do t'u japë përgjigje. Gjatë punimit do të përdoret edhe metoda statistikore, përmes saj do paraqitet me anë të statistikave dhe shifrave zyrtare gjendja e popullësisë së Kosovës gjatë vitit 1981. Janë përdorur edhe metodat e tjera të kërkimit shkencor, sikurse: përshkrimi, hulumtimi dhe krahasimi.

Pas përfundimit të studimit, në fund fare, në mënyrë të përgjithshme do të jepet edhe një përfundim i shkurtër në lidhje me këto ngjarje. Një mbështetje për punimin e këtij studimi është literatura e shumtë që kam shfrytëzuarë në gjuhën shqipe, angleze dhe gjermane. Pjesë e pandashme e kësaj trajtëse janë padyshim edhe të dhënat e shtypit të kohës, në shqip dhe pjesërisht në gjermanisht.

Punimi mbyllet me burimet arkivore dhe literaturën e gjerë të cilën e kemi shfrytëzuar, revistat shkencore, shtypin e kohës si dhe burime të ndryshme të shfrytëzuara nga interneti.